



# **BACHELOR** **DIZAJNI I INTERIERIT DHE** **INXHINIERI DRURI**

**NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU**

# Pse ky program studimi?

Kjo diplomë, në bashkëpunim me **Universitetin BOKU**, kombinon aftësitë teknike dhe krijuese, duke përgatitur studentët për një industri druri në rritje, me fokus tek zgjidhjet ekologjike dhe qëndrueshmëria.

Programi ofron përvojë praktike dhe trajnim të specializuar në dizenjimin, përpunimin dhe menaxhimin e materialeve druri, duke zhvilluar aftësi të avancuara teknike dhe kreative.

Studentët kanë mundësi të ndërtojnë karrierë si dizajner interieri, inxhinier i përpunimit të drurit, apo të angazhohen në projekte inovative të industrisë së drurit.


Ky program është ideal për ata që duan të bashkojnë talentin artistik dhe krijues me teknologjitë moderne, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së produkteve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës përmes zgjidhjeve të qëndrueshme dhe inovative në sektorin e drurit.

**Diplomë që njihet ndërkombëtarisht**



## Përshkrimi i programit

Programi Bachelor në Dizajn Interieri dhe Inxhinieri Druri kombinon aspektet shkencore, praktike dhe krijuese të përpunimit të drurit me dizajnin e hapësirave të brendshme. Kurrikula ofron njohuri mbi materialet e drurit, teknikat e prodhimit, parimet e dizajnit dhe planifikimin hapësinor, duke përgatitur studentët për karrierë në industrinë e drurit dhe dizajnin e brendshëm. Në vitin e tretë ofrohen dy profile specializimi: "Inxhinieri Teknologji Druri" dhe "Dizajni i Mobiljeve dhe Interierit", që rrisin njohuritë profesionale dhe mundësitë për punësim.



# Profili i të diplomuarit / Profil profesional

Të diplomuarit në Dizajn Interieri dhe Inxhinieri të Drurit formohen si profesionistë me aftësi krijuese, teknike dhe menaxheriale, të gatshëm për të dizajnuar hapësira dhe produkte druri funksionale, estetike dhe të qëndrueshme. Ata mund të ushtrojnë profesionin si:

- Dizajner interieri dhe mobiljesh, i angazhuar në projektimin e hapësirave dhe produkteve drusore;
- Specialist i teknologjisë së drurit, në kompani prodhimi dhe përpunimi të mobiljeve dhe elementëve drusorë;
- Konsulent dizajni dhe prodhimi, në studio dizajni, firma ndërtimi dhe arredimi;
- Profesional i pavarur (freelancer), për zhvillimin e produkteve inovative dhe ekologjike.



## Rudolf Nurçellari

Administrator, kompania  
"DruTech" shpk.

"Si student i diplomuar në Inxhinieri e Përpunimit të Drurit, synoj të kontribuoj në zhvillimin e industrisë së mobiljeve përmes njohurive teknike, kreativitetit dhe përpunimit profesional të drurit, duke krijuar produkte cilësore, funksionale dhe të qëndrueshme."



## Albion Dervishi

Administrator, kompania  
"Mobileri Dervishi"

"Me përgatitje akademike në Dizajnin e Mobiljeve dhe Interierit, fokusi im është krijimi i zgjidhjeve moderne dhe praktike për mobilje dhe ambiente të brendshme, duke kombinuar estetikën me funksionalitetin dhe duke u përshtatur me nevojat specifike të përdoruesit dhe trendet bashkëkohore të dizajnit."



## Orest Prifti

Interior dizajn "Bros Architects"

"Jam alumni i Universitetit Bujqësor të Tiranës në Dizajn Mobiljesh dhe Inxhinieri Druri, dhe aktualisht zhvilloj karrierën time pranë Bros Architects, duke kombinuar formimin akademik me përvojën praktike për të sjellë zgjidhje kreative në projekte."



## Olta Halili

Dizenjuese mobiljesh dhe inxhinierë  
në Mobilerinë Globi

"Si dizenjuese dhe inxhinierë mobiljesh, bashkoj kreativitetin me teknologjinë për të krijuar produkte funksionale, estetike dhe të qëndrueshme, duke sjellë inovacion dhe zgjidhje moderne që i përgjigjen nevojave të kohës."

# Kompetencat kryesore të fituara

Të diplomuarit do të fitojnë ekspertizë në:

- Teknologjitë e përpunimit të drurit: Aftësi në teknikat e përpunimit të drurit dhe teknologjitë inovative, duke përfshirë CAD dhe CNC.
- Dizajnim dhe krijimtarinë estetike: Përvetësimi i parimeve të dizajnit për të krijuar hapësira të rëndësishme, vizualisht tërheqëse dhe funksionale.
- Njohjen e materialeve me bazë druri: Kuptimi i vetive të drurit dhe materialeve me bazë druri, burimeve të qëndrueshme dhe praktikave të dizajnit ekologjik.
- Menaxhimin e projekteve dhe punën në ekip: Aftësi në menaxhimin e projekteve të dizajnit, planifikimin, buxhetin, prodhimin dhe punën efektive në ekip.

## PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

### LËNDËT BAZË

Disiplinë baze I,  
Disiplinë baze II,  
Fizikë e aplikuar,  
Biologji druri, etj.

### LËNDËT KARAKTERIZUESE

Teknologji druri II,  
Përpunimi primar i drurit,  
Përpunim druri me CNC,  
Prodhim mobiljesh, etj

### TË TJERA

Bazat e ekonomisë,  
Proceset e sistemet e punës,  
Politikat dhe ligjet,  
Menaxhim prodhimi, etj

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike. Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme.

## Mundësi Punësimi:

- **Inxhinier në fabrikat e drurit**, për menaxhim dhe prodhim mobiljesh.
- **Dizajner interieri dhe mobiljesh** në studio arkitekture ose dizajni.
- **Specialist i pavarur** për përmirësimin e cilësisë dhe dizajnit të produkteve.
- Punë në qendra shitjeje mobiljesh për prezantimin dhe reklamimin e produkteve.

# Të dhënat e programit

## Niveli i studimit

Cikli i parë, Bachelor

## Titulli akademik

Bachelor në Dizajn i Interierit dhe Inxhinieri Druri

## Kohëzgjatja

3 vite akademike / 6 semestra

## Kredite

180 ECTS

## Forma e studimit

Me kohë të plotë

## Gjuha e studimit

Shqip / Anglisht

## Kuota studimi

30 studentë

## Përfundimi i studimeve

Provim formimi / Temë diplome



# Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



## Për më shumë informacion vizitoni:

[www.ubt.edu.al](http://www.ubt.edu.al)

[info@ubt.edu.al](mailto:info@ubt.edu.al)

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

## MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Pas diplomimit në përpunimin e drurit, studentët kanë mundësi të vazhdojnë studimet Master në Inxhinieri të Përpunimit të Drurit, Dizajn & Interier. Këto programe ofrojnë specializim të avancuar, përgatitje për tregun evropian të punës dhe mundësi mobiliteti ndërkombëtar përmes Erasmus+ dhe diplomave të dyfishta me universitete partnere si BOKU (Vjenë), Tuscia (Itali) dhe Lublin (Poloni).

## FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti\_bujqesor\_tiranes  
fakulteti\_shkencave\_pyjore



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare  
Fakulteti i Shkencave Pyjore

*Për jetën dhe të ardhmen...*